



---

**VENDIM**

***Nr. 63 Datë 13 .09.2010***

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME  
SHUMICË PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.78, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

**Vendosi :**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

---

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10  
963  
Tirane  
69 590  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)